



Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Fakulteti i Sigurisë Publike
Fakultet Javne Bezbednosti/Faculty of Public Safety

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë
Odeljenje za osiguranje kvaliteta/Division for Quality Assurance

Raport i përgjithshëm i vlerësimit të mjedisit studimor nga ana e studentëve



Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

FSP: Fakulteti i Sigurisë Publike

ISP: Institucionet e Sigurisë Publike

PK: Policia e Kosovës

IPK: Inspektorati Policor i Kosovës

AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent

SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës

DK: Doganat e Kosovës

DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë

DSHS: Divizioni i Shërbimeve Studentore

DTI: Divizioni i teknologjise Informative

DSHP: Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta

SMU: Sistemi i Menaxhimit Universitar

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	2
Hyrja	4
Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC	5
Realizimi i pyetësorit.....	5
Të gjeturat e pyetësorit	5
Raport i përgjithshëm i vlerësimit	6
Administrata e FSP	8
Shërbimeve studentore në FSP	9
Biblioteka	10
Infrastruktura në kampus	11
Komentet e përmbledhura	12
Rekomandimet.....	13

Hyrja

AKSP është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë funksionon Fakulteti i Sigurisë Publike, i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Fakulteti ofron programe studimi për të gjitha institucionet e sigurisë publike, përkatësisht:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*

Arsimi i lartë në AKSP - Krahas aprovimit të Ligjit të AKSP-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: “Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik” implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimi u bë e mundur themelimi i Fakulteti i Sigurisë Publike gjegjësisht Arsimit të Lartë në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bolonjes, përkatësisht me standardet evropiane.

Sigurimi i cilësisë në AKSP - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në AKSP-ë dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative.

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë. Në këtë frymë janë krijuar pyetësor në cilësinë e mekanizmave matës dhe përmirësues në fushën e arsimit të lartë duke e vendosur studentin në qendër.

Në muajin Janar dhe atë Qershor 2024, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda AKSP, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në AKSP, përmirësimit të mjedisit studimor si një proces vazhdimisht i ndryshueshëm, DSC-ja ka realizuar pyetësorin elektronik me studentët e FSP-së, në nivelin Bachelor, në përfundim të semestrit dimëror, si një proces tashmë i zakonshëm. I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur kredibilitetin dhe prestigjin e institucionit.

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë është një divizioni i cili në veprim është i pavarur dhe funksionon nën Zyrën e Drejtorit të përgjithshëm të AKSP-së dhe raporton direkt tek drejtori i përgjithshëm i AKSP-së. DSC angazhohet në rritjen e cilësisë në AKSP duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentat matës të cilësisë të aprovuar në doracakun e cilësisë i cili rishikohet në baza të rregullta periodike konform ndryshimeve të reja dhe azhurnimeve të reja akterët relevant për të cilat DSC ofron raportet vlerësuese. DSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Drejtori i përgjithshëm i AKSP si dhe tek Dekani i FSP në raste të arsimit të lartë me qëllim të planifikimit të ngjitjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit studimor në kuadër të kampusit të FSP-së.

Realizimi i pyetësorit

DSC pas përfundimit të semestrit dimëror dhe atij veror për vitin akademik 2023/2024 ka lansuar pyetësorin elektronik për të gjithë studentët e nivelit bachelor në FSP duke filluar nga data 12 Janar 2024 për semestrin dimëror si dhe me datë 05 Qershor 2024 për semestrin veror në kuadër të vitit akademik 2023/2024. Pyetësori ka qenë anonim dhe i formatit elektronik i adresuar përmes platformës së domanit dsc.aksp@aksp-ks.org e cila njëherësh është e ndërlidhur me përpunimin e të dhënave elektronike duke shfrytëzuar sistemet e licencuara të google forms. Studentët janë përgjigjur përmes sistemit elektronik i cili në kuadër të një pyetësorit për vlerësimin e mjedisit studimor nga ana e studentëve dhe pyetësori ka përmbajtur 20 pyetje nga fusha e administratës, shërbimeve, logjistikës, bibliotekës si dhe shërbimeve tjera në kuadër të FSP gjithnjë duke vendosur studentin në qendër.

Të gjeturat e pyetësorit

Pyetësorët elektronik të plotësuar nga ana e studentëve në FSP bazuar në të cilën neve konsiderojmë se kemi pas një pjesëmarrje prezantuese të mjaftueshme. DSC ka bërë shpërndarjen elektronike të pyetësorit si dhe njoftimet paraprake dhe rikujtuese përmes SIS-sistemit elektronik. Gjegjësisht është shpërndarë pyetësori i përgjithshëm për vlerësimin e mjedisit studimor nga ana e studentëve dhe kemi pranuar gjithsejtë 400 përgjigje. Për të ofruar të dhëna më të detajuara, më poshtë do gjeni të gjeturat e ndara në raporte sipas drejtimeve të caktuara veq e veq. Ky raport njëherësh shprehë statistikën e përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga tërësia e përgjigjeve në nivel të fakultetit si dhe për mjedisin studimor dhe elementet tjera përbërëse në kuadër të pyetësorit. DSC dërgon gjetjet tek Dekani i FSP, dhe raportet si të tilla diskutohen me stafin akademik dhe administrativ si dhe menaxhmentin e AKSP.

Raport i përgjithshëm i vlerësimit

Objektivi: Vlerësimi i cilësisë së mjedisit studimor që ofron AKSP me elementet përbërse në kuadër të programi bachelor i sigurisë publike

Qëllimi: Me anë të këtij vlerësimi pritet të arrihet përmirësimi dhe siguri i vazhdueshëm i cilësisë në ofrimin e mjedisit studimor i cili perkon me vizionin, misionin dhe zotimet e AKSP per studentët e FSP-së.


Viti akademik 2023/2024

Kategorizimi i vlerësimit sipas % së fituar zbërthyer në notë vlerësimi

Nuk pajtohem aspak	0%-20%	nota e vlerësimit 1	Sqarim: Nota e vlerësimit 5 (pesë) përfaqëson vlerësim maksimal, ndersa nota e vlerësimit 1 (një) përfaqëson vlerësimin minimal.
Nuk pajtohem	21%-40%	nota e vlerësimit 2	
Neutral	41%-60%	nota e vlerësimit 3	
Pajtohem	61%-80%	nota e vlerësimit 4	
Pajtohem plotësisht	81%-100%	nota e vlerësimit 5	

Nga vlerësimet e pranuar kemi këto të dhëna si në vijim:

Nuk pajtohem aspak	22	6%
Nuk pajtohem	21	5%
Neutral	114	29%
Pajtohem	93	23%
Pajtohem plotësisht	150	38%
total pergjigje	400	




Mesatarja e kalueshmërisë	76.4%
Nota e përgjithshme	3.82

Analiza e vlerave numerike te fituara

Pyetjet e pyetësorit		Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	mesatarja %	nota e vleresimit
<u>Si e vlerësoni administratën në FSP?</u>	<u>Administrata ofron shërbime efikase për student</u>	5.00%	5.00%	25.00%	25.00%	40.00%	78.00%	3.90
	<u>Shpalljet dhe njoftimet për student ofrohen në kohë nga administrata</u>	5.00%	5.00%	20.00%	20.00%	50.00%	81.00%	4.05
	<u>Administrata ofron këshilla për student gjatë tërë kohës</u>	10.00%	0.00%	25.00%	30.00%	35.00%	76.00%	3.80
	<u>Administrata ofron udhëzime për SIS dhe SMU sistemin e aplikuar</u>	10.00%	0.00%	25.00%	30.00%	35.00%	76.00%	3.80
	<u>Administrata ka personel të mjaftueshëm dhe profesional</u>	10.00%	5.00%	20.00%	20.00%	45.00%	77.00%	3.85
<u>Si e vlerësoni nivelin e shërbimeve studentore?</u>	<u>Ne jemi të mbështetur nga shërbimet studentore në kampus</u>	5.00%	5.00%	25.00%	30.00%	35.00%	77.00%	3.85
	<u>Ne jemi të kënaqur me shërbimet e ofruara studentore</u>	5.00%	5.00%	25.00%	35.00%	30.00%	76.00%	3.80
	<u>Shërbimet studentore ofrojnë materiale shtesë informuese dhe këshilluese</u>	5.00%	5.00%	35.00%	20.00%	35.00%	75.00%	3.75
	<u>Shërbimet studentore organizojnë aktivitete shtesë për student</u>	5.00%	5.00%	40.00%	20.00%	30.00%	73.00%	3.65
	<u>Shërbimet studentore ofrojnë njoftime të rregullta javore në kohë reale (oraret javore të klasëve, menzës dhe aktiviteteve tjera)</u>	5.00%	5.00%	45.00%	15.00%	30.00%	72.00%	3.60
<u>Si e vlerësoni nivelin e bibliotekës në kampus?</u>	<u>Biblioteka posedon staf profesional dhe të mjaftueshëm</u>	0.00%	5.00%	20.00%	30.00%	45.00%	83.00%	4.15
	<u>Biblioteka vepron me orar të përshtatshëm për student</u>	0.00%	5.00%	30.00%	25.00%	40.00%	80.00%	4.00
	<u>Biblioteka posedon literaturë të mjaftueshme nga fusha profesionale</u>	0.00%	10.00%	30.00%	25.00%	35.00%	77.00%	3.85
	<u>Biblioteka posedon literaturë në gjuhën e komuniteteve si dhe në gjuhë të huaja (gjuha angleze)</u>	0.00%	5.00%	35.00%	15.00%	45.00%	80.00%	4.00
	<u>Biblioteka ofron qasje edhe në formatin elektronik</u>	0.00%	5.00%	40.00%	40.00%	35.00%	77.00%	3.85
<u>Si e vlerësoni nivelin e Infrastrukturës në kampus?</u>	<u>Kampusi ofron mbështetje me shërbime logjistike në nivelin e duhur</u>	5.00%	10.00%	20.00%	35.00%	30.00%	75.00%	3.75
	<u>Hapësirat e kampusit mirëmbahen mirë</u>	5.00%	5.00%	30.00%	10.00%	50.00%	79.00%	3.95
	<u>Kampusi posedon kabinetin e IT me kompjuter</u>	10.00%	10.00%	30.00%	20.00%	30.00%	70.00%	3.50
	<u>Menza për student është e nivelit të duhur</u>	15.00%	0.00%	25.00%	15.00%	45.00%	75.00%	3.75
	<u>Shërbimet mbështetëse logjistike (lavanderia, shërbimet mjekësore) janë në nivelin e duhur</u>	10.00%	10.00%	25.00%	25.00%	30.00%	71.00%	3.55

Administrata e FSP

Bazuar në të gjeturat e fituara pas analizimit të dhënave dhe gërshetimit me komentet plotësuese në kuadër të përgjigjeve të fituara, në FSP vërehet një nivel mbi mesataren e kënaqshmërisë me shërbimet administrative në kuadër të FSP.




Edhe pse administrata aktuale e FSP-së është e plotësuar me personel nga DSHS, procesi i ristrukturimit të administratës së FSP mbetet ende në kuadër të procesit të ristrukturimit aktual në kuadër të MPB-së.

Përkundër sfidave aktuale, niveli i kënaqshmërisë së studentëve me stafin e përkohshëm aktual që ofrojnë shërbime në FSP, mbetet mbi nivelin mesatar. Administrata aktuale që funksionin në kuadër të FSP-së është vlerësuar se ka një nivel të kënaqshëm profesional përfshirë edhe pjesën teknike dhe këshilluese për studentët e FSP-së.

Numerikisht stafi i angazhuar plotësojnë nevojat e studentëve dhe stafit akademik në kuadër të FSP-së e cila administratë përbëhet nga dy (2) zyrtar nga Departamenti i Trajnimeve dhe Perkrhjes Arsimore gjegjësisht nga Divizioni për Shërbime Studentore si dhe një zyrtar i përkohshëm në pozicionin e zyrtarit për Internship në FSP.

Shërbimeve studentore në FSP

Bazuar në përgjigjet e studentëve të FSP-së, niveli i kënaqshmërisë me shërbimet studentore është mbi mesataren bazuar në zyrtarët e emëruar nga DSH-ja që ofrojnë shërbime në kuadër të administratës së FSP-së.




Divizioni për shërbime studentore bazuar në organogramin aktual ofron shërbime të natyrës teknike në kuadër të AKSP-së dhe i përgjigjet DTPA-së. Përfshirja zyrtarëve të caktuar në kuadër të administratës së FSP-së, DSHS është e përcaktuar në fushën e trajnimeve që organizohen në AKSP, gjegjësisht pjesës teknike të komunikimit, dhe asaj logjistike të ofrimit të hapësirave arsimore me oraret përcjellëse javore. Në fakt nuk gëzon asnjë planifikim për aktivitete shtesë jashtë kurrikulare të cilat i ka në mandat.

DSHS-ja poashtu mbetet ende peng i procesit të ristrukturimit aktual në kuadër të MPB-së, dhe pritjet janë që të përcaktohen administrata e FSP-së në kuptimin funksional në kuadër të organigramit duke përfshirë edhe DSHS si pjesë e strukturës për arsimin e lartë.

Biblioteka

Biblioteka është vlerësuar me nivelin mesatar të kënaqshmërisë nga studentët e FSP-së. Sipas të gjeturave, përkundër faktit që ende kemi lokacionin e vjetër të saj, (përkundër planfikimeve për inventarizim nga AKSP, për rialokimin e saj në ndërtesën e re të Fakultetit) studentët janë të kënaqur me shërbimet aktuale në lokacionin aktual. Vlerësimi përfshin stafin profesional, literaturën dhe qasjen që ofron biblioteka.




Aktualisht në bibliotekë kemi vetëm një zyrtarë e cila në aspektin profesional është e trajnuar dhe e përgaditur me kompetencë për të ofruar këshilla, udhëzime si dhe shërbime teknike në kuadër të formatit elektronik dhe atij të regjistrimit fizik të literaturës që AKSP posedon.

Bazuar në strategjinë e AKSP, pjesa e organizimit dhe pasurimit të bibliotekës është njëri ndër aktivitetet kyqe në AKSP dhe në baza vjetore AKSP në koordinim me stafin akademik dhe nevojat e identifikuara bën planifikimin e blerjeve të librave konform nevojave të adresuara nga studentët dhe stafi akademik. Nga fusha e marrveshjeve ndërkombëtare AKSP ofron edhe qasje në bibliotekën online duke ofruar me qindra tituj të ndryshëm për student të FSP-së.

Sa i përket literaturës në gjuhët e komuniteteve në vend përkundër numrit të studentëve nga komunitetet tjera, AKSP posedon 390 ekzemplarë, prej të cilave në gjuhën serbe, boshnjake dhe turke të formateve dhe fushave të ndryshme të interesit për student.

Infrastruktura në kampus

Bazuar në të gjeturat e fituara pas analizimit të dhenave dhe gërshetimit me komentet plotësuese në kuadër të përgjigjeve të fituara, në FSP verehet një nivel mesatar i kënaqshmerise me kampusin dhe infrastrukturën që posedon kampusi duke përfshirë edhe elementet përcjellëse qofshin ato të shërbimeve logjistike apo edhe të atyre teknike nga fusha e IT duke përfshirë edhe objektet tjera përcjellëse në kuadër të kampusit të AKSP-së.



Në kuadër të kampusit të AKSP ofrohen shërbime profesionale, logjistike, tekniko administrative, siguria e kampusit si dhe elementi kyq i mirëmbajtjes në baza ditore.

Në fushën e mbështetjes logjistike, studentët kanë shprehur nevojën për mbështetje më të koordinuar të shërbimeve logjistike sidomos në fushën e asaj logjistike, hapësirat e vogla, mungesa dhe ende mos-shfrytëzimi i objektit të Fakultetit si pasojë e vonesave në inventarizim. Vlen të ceket se në kuadër të infrastrukturës që posedon AKSP, përkundër kabinetit të IT, AKSP ofron edhe menzën për student e cila ofrohet dhe mbulohet nga AKSP. Poashtu si shërbimet tjera logjistike ofrohen edhe; lavanderia dhe shërbimet mjekësore.

Shërbimet mjekësore aktuale ofrohen vetëm në aspektin ambulator dhe të thjeshtë teknik-medicinal në mungesë të mjekut për të cilin AKSP ka hapur konkurs tash e një kohë, dhe përkundër kushteve të ofruara vendi ende nuk është plotësuar si mungesë e kuadrove në vend.

Vlerësimet e pranuar për pjesën logjistike dhe shërbimet mbështetëse janë mesatare me nevojë për përmirësim në shërbime logjistike, mirëmbajtje dhe ngritje të nivelit të këtyre shërbimeve në përgjithësi.

Komentet e përmbledhura

Studentët e FSP-së në pjesën e dedikuar për komente kanë shfaqur sinjeritet dhe indikacione për përmirësim të AKSP në aspektin mbështetëse lgjistik. Në përgjithësi komentet kanë qenë të natyrës specifike dhe kërkesat janë në nivel të planifikimeve të vetë institucionit në kuadër të strategjive në fushën e përmirësimit të shërbimeve logjistike. Në përgjithësi kemi pranuar komente pozitive dhe inkurajuese për përmirësim sidomos në aspektin e shërbimeve logjistike dhe elementeve përbërëse te saj.

Po ashtu është vërejtur një motivim shtesë bazuar në kushtet që posedon AKSP në kuadër të objekteve shtesë ndihmëse e sidomos nëse i shtojmë faktin e ndërtesës së re të Fakultetit të Sigurisë Publike e cila i plotëson të gjitha kushtet moderne për zhvillimin e studimeve në AKSP si një mjedis miqësor, modern dhe i kompletuar.

Në kuadër të komenteve të ofruara janë regjistruar disa fusha për përmirësim të vazhdueshëm sidomos në kuadër të mbështetjes logjistike të cilat procese janë në fazët testuese.

Në total kemi pranuar dhe analizuar te gjitha komentet e pranuar.

Rekomandimet

Divizioni për sigurimin e cilësisë në AKSP, pasi që ka shqyrtuar përgjigjet e studentëve të nivelit Bachelor në FSP dhe pas analizës së të gjitha pyetjeve dhe komenteve, në këtë fazë të zhvillimit të institucionit, i rekomandon menaxhmentit të lartë të FSP që të merren hapat si më poshtë:

- Krijimi i strukture organizative ne kuader te organogramit te AKSP/FSP të llojit permanent dhe te tipit referues me Institucionet tjera te arsimit te lart, duke ofruar edhe ngritjen e kapaciteteve në fushën profesionale dhe kompetente përmes ofrimit të trajnimeve të zyrtarve të administratës së FSP-së.
- Të investohet vazhdimisht në trajnime të stafit administrativ për metoda e reja të aplikimit elektronik duke përfshirë edhe sistemet elektronike të SIS, SMU dhe Moodle;
- Të ketë përmirësime të vazhdueshme në kuadër të shërbimeve logjistike për hapësirat të cilat shfrytëzohen nga studentët e FSP-së, si dhe plotësimin e hapësirave me persona të fushës në kuadër të njësive që ofrojnë shërbim për studentët e FSP.
- Shqyrtimin e mundësive të krijimit të aktiviteteve shtesë për student sidomos në krijimin e mjediseve efektive të të mësuarit;
- Po ashtu kerkohet qe te krijohet nje plan pune i administrates së FSP në të cilin plan do definoreshin oraret për keshillim, shërbime dhe aktivitete tjera jashte atij akademik kuptohet në kuadër të DSHS i cili do duhej te ishte një nga shtyllat e strukture se arsimit te larte.